



**Republika e Kosovës**

**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**

***Kuvendi - Skupština – Assembly***

---

**Legjislatura IV**

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 53/12

Prishtinë, më 22.03.2012, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA**

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontić, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Albana Fetoshi, Muhamet Mustafa, Duda Balje dhe Xhevdet Neziraj.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli, Ardita Fejza (praktikante).

Gjithashtu ishin të pranishëm: Bedri Hamza Ministër i Financave, Lulzim Ismajli Drejtor i Dep. Ligjon në MF, Anne Schwartz nga Thesari Amerikan, Arbërie Buçaj nga BQK, Ramadan Islami, Njomza Ilazi nga GIZ, monitorues nga KDI.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

**Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i raportit me rekomandime të grupit punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin nr.04/L-93 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare;**
- 3. Të ndryshme.**

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendit ditës miratohet njëzëri.

## **2. Shqyrtimi i raportit me rekomandime të grupit punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin nr.04/L-93 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare**

**Kryetarja**, njoftoi se grupi punues ka punuar intensivisht në amendamentin e dispozitave të projektligjit, në të cilat takime kanë marrë pjesë Drejtori i Zyrës Ligjore të MF-it, përfaqësues të BQK-së dhe të Thesarit Amerikan, për çka i falenderoi për kontributin e tyre. Një ndër arsytet pse kanë dalur shumë amendamente është për shkak të përkthimit jo të mirë të projektligjit në gjuhën shqipe krahasuar me atë në gjuhën angleze dhe pjesa më e madhe janë propozime teknike.

**Latif Gashi**, theksoi se shumica e amendamenteve të propozuara janë bazuar në ekspertizën që ka propozuar eksperti nga Shqipëria i angazhuar nga komisioni, që gjithashtu ka pasur vërejtje në përkthimin e tekstit në gjuhën shqipe, krahasuar me versionin në gjuhën angleze dhe serbe. Shumica e intervenimeve dhe propozim-ndryshimeve janë teknike dhe nuk është ndryshuar diçka në substancë apo në përmbajtjen e projektligjit. Si rrjedhojë kanë dalur shumë amendamentet.

Në vazhdim filloi votimi i amendamenteve:

Amendamenti 1 miratohet njëzëri, Amendamenti 2 miratohet me një votë kundër (Albana Fetoshi) dhe të gjithë anëtarët tjerë Për dhe asnjë abstenim. Amendamenti 3 miratohet me një votë kundër (Albana Fetoshi) dhe të gjithë anëtarët tjerë Për dhe asnjë abstenim. Amendamenti 4 miratohet njëzëri.

**Kryetarja**, theksoi se amendamenti 5 ka të bëjë me përkufizimin bankë dhe propozoi që ky ndryshim të kalojë të amendamenti ku janë bërë përkufizimet – miratohet njëzëri. Amendamenti 6, 7 dhe 8 miratohen njëzëri. Amendamenti 9 miratohet njëzëri me plotësimin që në fund të paragrafit 7 shtohet teksti dhe “burimi i ligjshëm i kapitalit”. Amendamenti 10, amendamenti 11 miratohen njëzëri. Amendamenti 12 miratohet njëzëri me ndryshimin e fjalës “përfundim” në “detyrim”. Amendamenti 13 miratohet njëzëri. Amendamenti 14 miratohet njëzëri, me plotësimin që në paragrafin 2 në rreshtin e parë, pas fjalës “operon”, shtohet fjala “në”. Në vazhdim amendamenti 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41 dhe 42 u miratuan njëzëri.

**Kryetarja**, sa i përket amendamentit 43, njoftoi se ka pasur një takim me përfaqësuesit e EULEX-it dhe kanë propozuar që ky amendament që i referohet ndryshimit të nenit 83 paragrafit 2 të riformulohet, ku do të thuhet: institucionet financiare veprojnë në përputhje me ligjin për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit Banka Qendrore të Kosovës dhe Njësia e Intelgjencës financiare zhvillojnë bashkëpunim përmes nënshkrimit të memorandumit të mirëkuptimit.

**Albana Fetoshi**, theksoi se unë mendoj që nuk është në rregull që memorandum i bashkëpunimit të futet në ligj.

**Bedri Hamza**, theksoi se nëse nuk nënshkruhet memorandum njësia e inteligjencës mund të dalë jashtë fushëveprimit të vet, edhe të veproj në kundërshtim me gjërat e caktuara, prandaj nuk e rëndon ligjin.

**Latif Gashi**, theksoi se ky projektligj është hartuar në bashkëpunim me FMN, standardet dhe direktivat e BE , me pjesëmarrjen e faktorëve relevant dhe nuk prish punë për futjen e memorandumit në ligj, pasi që është në funksion të bashkëpunimit në mes palëve.

**Muhamet Mustafa**, propozoi që mos të përmendet memorandum i mirëkuptimit, por të thuhet se BQK dhe Njësia e Intelejencës Financiare zhvillojnë marrëdhënie bashkëpunimi në bazë të dispozitave ligjore.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, komisioni njëzëri miratoi amendamentin 43 që i referohet ndryshimit të paragrafit 2 me këtë tekst: “Institucionet financiare veprojnë në përputhje me ligjin për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit Banka Qendrore të Kosovës dhe Njësia e Intelejencës financiare zhvillojnë bashkëpunim në pajtim me ligjet në fuqi.

**Kryetarja**, njoftoi se nga takimi që ka pasur me EULEX-in është kërkuar që edhe amendamenti 44 që ka të bëjë me nenin 84 paragrafi 1 të ndryshohet apo të fshihet, pasi që nuk është në pajtim me Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe parandalimit të terrorizimit.

Komisioni, njëzëri miratoi amendamentin 44, me të cilin fshihet paragrafi 1 i nenit 84 të projektligjit. Në vazhdim u miratuan njëzëri amendamenti 45,46,47,48 dhe 49.

**Muhamet Mustafa**, sa i përket nenit 50 që i referohet ndryshimit në nenin 95, nënparagrafi 1.7, te çështja e dividendës nuk do të duhej të ishte se që institucionet përkatëse nuk mund të shpërndajnë dividendë, pasi që me vetë faktin që janë shoqëri aksionare, ato duhet të deklarojnë dividendë dhe do të duhej të ishte nuk mund të paguajnë dividendë.

Komisioni me nje votë Kundër (Albana Fetoshi) dhe të gjithë anëtarët tjerë për dhe asnjë abstenim, miratoi amendamentin 50 që i referohet ndryshimit të nenit 95, nënparagrafi 1.7 me ndryshimin që në vend të ndalimit të deklarimit të dividendës nga institucionet financiare të thuhet nuk kanë të drejtë të paguajnë dividendë pa miratimin nga BQK.

Në vazhdim amendamenti 51,52,53,54,55,56,57,58,59 dhe 60 u miratuan njëzëri. Ndërkaq amendamenti 61 u miratua një abstenim (Albana Fetoshi) dhe të gjithë anëtarët tjerë Për dhe asnjë kundër.

**Hykmete Bajrami**, sa i përket amendamentit 62, theksoi se nuk kam të qartë tek ky amendament, ku mbetet kapitali aksionar dhe kush është pronar i atij kapitali?

**Ana Schwartz**, sqaroi se nenin 110 është e sqaruar çështja e likuidimit vullnetar dhe kthimit të mjeteve të donatorëve nga institucionet mikrofinanciare.

**Latif Gashi**, theksoi e projektligji nuk paragjykon shndërrimin e institucioneve mikrofinanciare në banka, ai nxjerr dhe rregullon thelbin e tyre, që nëse ato dëshirojnë të shëndrrohen, duhet t'i plotësojnë kriteret e caktuara.

**Sali Asllanaj**, theksoi kemi të bëjmë me një përfitim të madhë që kanë realizuar këto institucioni dhe çështja e suficitit mund të jetë një rrezik i mundshëm.

**Lulzim Rafuna**, sqaroi se Neni 101 ka të bëjë vetëm me procedurë të likuidimit.

**Hykmete Bajrami**, pyeti a pritet ndonjëherë që të keni likuidim vullnetar?

**Lulzim Rafuna**, sqaroi se është obligim i institucioneve mikrofinanciare që nga dita e miratimit të këtij ligji që Brenda 3 muajve të shkojnë në Ministrinë e Tregtisë dhe të regjistrohen si shoqëri aksionare.

**Naser Osmani**, unë mendoj që nëse lexohet amendamenti 62 është e sqaruar shumë mirë përveç që duhet një formulim tek "donator fillestar" vendosim pikë dhe vazhdojmë me "Nëse kapitali i fillestar i donatorëve nuk kthehet, suficiti i kapitalit do të shpërndahet për qëllime bamirësie sipas planit të miratuar nga BQK".

Komisioni miratoi amendamentin 62 me ndryshimet e propozuara, u miratua me dy vota Kundër (Albana Fetoshi dhe Sali Asllanaj) dhe të gjithë anëtarët tjerë për dhe asnjë abstenim.

Amendamenti 63 u miratua me një votë Kundër (Albana Fetoshi), një Abstenim (Hykmete Bajrami) dhe të gjithë anëtarët tjerë për.

Amendamenti 64 që i referohet ndryshimit të nenit 111 i cili bëhet neni 112, u miratua me një votë Kundër (Albana Fetoshi), një Abstenim (Hykmete Bajrami) dhe të gjithë anëtarët tjerë për, me këtë ndryshim në fjalinë e parë të paragrafit 1: Një institucion mikrofinanciar mund të investoj në pronësi të një banke deri në maksimumin prej njëzetepesë përqind (25%), të kapitalit aksionar të asaj banka me miratimin e BQK-së." Amendamenti 65 u miratua njëzëri me këtë riformulim: "Institucionet financiare veprojnë në përputhje me ligjin për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit Banka Qendrore të Kosovës dhe Njësia e Intelejencës financiare zhvillojnë bashkëpunim në pajtim me ligjet në fuqi."

Amendamenti 66 dhe 67 miratohen njëzëri. Amendamenti 68, miratohet me një votë Abstenim (Albana Fetoshi) dhe të gjithë anëtarët tjerë për.

**Kryetarja**, njoftoi anëtarët se për shkak të bashkimit të ndonjë amendamenteve që i referoheshin neneve të njëjta dhe që janë teknike, do të kemi më pak amendamente në numër, por që gjithësesi të gjitha ndryshimet dhe plotësimet do të përfshihen.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni me tetë vota PËR (Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontić, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Muhamet Mustafa, Duda Balje dhe Xhevdet Neziraj), dy Kundër (Sali Asllanaj dhe Albana Fetoshi) dhe një Abstenim (Hykmete Bajrami), nxori këtë:

## **REKOANDIM**

Miratoohen propozim-amendamentet e grupi punues për projektligjin për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare, me ndryshimet e bëra në komision. Raporti me amendamente procedohet për shqyrtim dhe miratim në procedurat e mëtutjeshme të Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në ora 12:00.

**Përgatitur nga:**

**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

**Kryetarja e Komisionit**

---

**Safete Hadergjonaj**